

THE IMPORTANCE OF WITNESS DOCUMENT AS PROVE IN PROCEDURAL PENALTY

Arbenita Hoxha

arbenita.hoxha1@gmail.com

Abstract: The purpose of this study is to examine the seriousness of the witness in the Kosovo criminal procedure. Just as criminal proceedings during its development until today have encountered difficulties during its implementation, as well as the witness as part of this procedure has undergone various difficulties while being in different positions during certain periods. In this paper, efforts will be made to show the rank and weight of the witness.

The witness questioning procedure should be based on the law, while providing the witness with the necessary protection in order to embrace the information as accurate as possible. During the preparation of this scientific paper, a number of methods were used in the research and development of knowledge about the witness, using as a basis the Law on Criminal Procedure and the necessary literature which makes us more clearly understand its importance in the probation procedure.

The paper focuses on the practice of questioning the witness by assessing the benefits and disadvantages of this process by having the opportunity to influence in the future in improving the questioning of the witness by not breaking the rules on probation procedure and by providing a security that would enable any person called witnesses to perform his duty with full dignity and seriousness without feeling endangered by external influences if he feels as contributory to the development and promotion of justice in the country.

Keywords: Criminal proceedings, criminality, probation procedures, probationary means.

RËNDËSIA E DËSHMISË SË DËSHMITARIT SI PROVË NË PROCEDURËN PENALE

Arbenita Hoxha

arbenita.hoxha1@gmail.com

Abstrakt: Synimi i këtij studimi është që ta shqyrtojmë rëndësinë e dëshmitarit në procedurën penale të Kosovës. Ashtu sikurse procedura penale përgjatë zhvillimit të saj deri në ditët e sotme ka hasur vështirësi gjatë zbatimit të saj po ashtu edhe dëshmitari si pjesë e kësaj procedure ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme duke qenë në pozitë të ndryshme përgjatë periudhave të caktuara. Në këtë punim do të bëhet përpjekje për të treguar pozitën dhe rëndësinë e dëshmitarit.

Procedura e pyetjes së dëshmitarit duhet të jetë e bazuar në ligj, njëkohësisht duke i ofruar dëshmitarit mbrotjen e nevojshme në mënyrë që të thithet informacioni sa më i saktë. Gjatë përgaditjes së këtijpunimi shkencor janë përdorur një sërë metodash në kërkimin dhe zhvillimin e njohurive rreth dëshmitarit duke e shfrytëzuar si bazë Ligjin e procedurës penale dhe literaturën e nevojshme e cila na bën të kuptojmë më qartë rëndësinë e tij në procedurën provuese.

Punimi fokusohet në praktikën e marrjes në pyetje të dëshmitarit duke vlerësuar të mirat dhe të metat e këtij procesi duke pasur mundësi që me këtë punim të ndikojmë në të ardhmen në përmirësimin e marrjes në pyetje të dëshmitarit duke mos u shkelur rregullat mbi procedurën provuese dhe duke i ofruar një siguri që do të mundësonte çdo personi të thirrur si dëshmitarë ta kryente detyrën e tij me dinjitet dhe seriozitet të plotë duke mos u ndier i rrezikuar nga ndikimet e jashtme po të ndihet si kontributdhënës në zhvillimin dhe promovimin e drejtësisë në vend.

Fjalët kyçe: Procedura penale, kriminaliteti, procedura provuese, mjetet provuese.

HYRJE

Për ndriçimin dhe zgjidhjen e sukseshme të një çështje juridike është e nevojshme që në procedurë penale të ndërmerren një varg veprimesh me ndihmën e të cilave gjykata duhet të konstatojë të vërtetën në procedurën penale, e kjo mund të arrihet me vërtetimin e fakteve relevante të cilat janë të rëndësishme juridiko penale materiale dhe procedurale.

Vërtetimi i saktësisë së një fakti relevant juridik në procedurë penale quhet provim, ndërsa provimi bëhet me ndihëm e provave të cilat i parashtrihen gjykatës me ndihëm e mjeteve të ndryshme provuese. Prej të gjitha mjeteve provuese dhe provave të cilat mund të përdoren në procedurën penale në këtë rast na i intereson dëshmitari dhe dëshmia e tij si provë në atë procedurë.

Me rastin e marrjes së dëshmisë së dëshmitarit vlersimit dhe përdorimit të saj si provë në procedurë penale, provë e cila është lidhur me psikologjin e deklaratës paraqiten edhe vështirësi. Si provë, dëshmia e dëshmitarit bën pjesë në grupin e provave personale burim i të cilave është njeriu. Andaj, më tutje vëmendja e këtij punimi do të përqëndrohet në shqyrtimin e pozitës së dëshmitarit si mjet provues dhe rëndsinë e dëshmisë së tij në procedurë penale si dhe një varg çështjes të cilat kanë të bëjnë me të.

Trajtimi i pozitës dhe rolit të dëshmitarit në procedurën penale dhe rëndësisë së dëshmisë së tij si provë në procedurë penale është bërë duke u nisur nga Ligji i procedurës penale njëkohësisht duke u përpejkur në atë rast që çështjet e parashtruara si objekt i këtij studimi të analizohen dhe të vështrohen nëpërmjet rregullave juridike të cilat pak a shumë paraqesin zgjidhje përgjithësisht të pranuar të cilat hasen edhe te të drejtat tjera pozitive.

RËNDËSIA E DËSHMISË SË DËSHMITARIT SI PROVË NË PROCEDURËN PENALE

Siç e dimë pa prova nuk mund të zbardhet çështja. Atëherë është mëse e qartë se procedura provuese është thuajse procedura vendimtare nga e cila përcakton fajësinë apo pafajësinë e të dyshuarit. Duhet pasur kujdes gjatë vlerësimit të provave, që duhe I shqyrtuar hollësisht të arrijme tek rezultati I dëshiruar, e që në këtë rast është ndarja e drejtësisë. Dëshmitari është mjet provues më I shpeshtë në procedurë penale.

Dëshmia e tij si provë, përkundër kritikave ekzistuese rreth besnikërisë dhe sigurisë së saj, është e pazëvendësueshme në procedurë penale.²²⁸

Se është e rëndësishme dëshmia e dëshmitarit këtë e ka treguar edhe praktika ku në shumë raste dëshmia ka qenë mjeti provues e cila I ka dhënë kahje drejtësisë.

Është mjaft e rëndësishme marrja e dëshmisë së dëshmitarit si provë, sepse në praktikë shumë shpesh mund të ndodhë kur kjo deklaratë e dëshmitarit për shkak të lëshimevë ajo bëhet e papranueshme. Ajo është e papranueshme në disa rrethana:

a) Personi nuk mund të pyetet si dëshmitarë, këtë i'a mundëson legjislacioni në fuqi, pra ekzistojnë persona të cilët nuk mund të pyeten në cilësinë e dëshmitarit.

b) Personi është liruar nga dëshmimi por nuk është vënë në dijeni për këtë ose shprehimisht nuk ka hequr dorë nga kjo e drejtë, apo kur udhëzimi dhe heqja dorë nuk është shënuar në procesverbal gjyqtari I vetëm gjykues apo kryetari I trupit gjykues duhet ta informojë dëshmitarin I cili është I liruar nga dëshmimi në mënyrë që ai të vendos vet nëse dëshiron të dëshmojë apo jo, e gjithë kjo duhet të shënohet në procesverbal, pasi që në procesverbal mbahen të gjitha shënimet për rrjedhen e procedurës.

c) Personi është fëmijë, i cili nuk kupton të drejtën e tij për të refuzuar dëshmimin, fëmijët janë kategori e veçantë dhe për këtë ur kemi të bëjmë me dëshmitarë që janë fëmijë, psikologu duhet të jetë I pranishëm për të vlerësuar shkallen e zhvillimit mendor të tijë.

d) Dëshmia e dëshmitarit të marrë me force, me kanosje ose me ndonjë mënyrë tjetër të ndaluar. Dëshmia e marrur me force paraqet provë të papranueshme pasi që personi I cili jep dëshminë mund të jetë I detyruar pa dëshirën e vetë të japë dëshmi ne favor të një personi apo shumë personave me çrast ia vështirëson gjykatës vënien e drejtësisë, për këtë arsye legjislacioni jonë në fuqi ka paraparë edhe masat të cilat mund të merren për mbrojtjen e dëshmitarevë të cilët konsiderohen në rrezik.

Marrja e deklaratës në mënyrë të drejtë nuk është pcoses mjaft I thjeshtë, andaj prokurori, gjyqtari apo policia kushdo që e merr në pyetje dëshmitarin duhet të ketë kujdes rreth çmuarjes së kësaj prove të rëndësishme sepse nëse ajo është e papranueshme procesi vetëm sa ndërlikohet me shume e cila mund të sjell deri tek shkeljet eseciale e dispozitave ligjore të procedurës penale e cila lehtë bëhet shkas për ankesë e ndoshta edhe për prishjen e vendimit.

²²⁸ Ejup Sahiti Dëshmia e Dëshmitarit fq 134

MBROTJA E DËSHMITARIT DHE MASAT MBROJTËSE

Dëshmia e dëshmitarit si provë është mjaft e rëndësishme sepse vetëm provat dhe informatat e sakta janë ndihmesë e madhe në luftën kundër kriminalitetit, andaj krahas rëndësisë së dëshmisë së dëshmitarit si provë shpesh herë është paraqitur nevoja për t'iu ofruar mbrojtje.

Këtë mbrojtje ua ofrojnë dispozitat ligjore të Kodit të procedurës penale të Kosovës si dhe Ligji për mbrojtjen e dëshmitarëve nr. 04/-L-015.

Kodi i procedurës penale në mënyrë shprehimore përmbanë një mori dispozitash lidhur me mbrojtjen e dëshmitarëve dhe të dëmtuarit në procedurë penale. Këto dispozita janë të rëndësishme jo vetëm për mbrojtjen e këtyre personave dhe familjarëve të tyre por edhe për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale në terësi.

Me qëllim që kjo mbrojtje të mundësohet në mënyrë sa më funksionale ligjdhënësi ka paraparë mundësinë që ndaj të dëmtuarit dhe dëshmitarit të zbatohen masat mbrojtëse. Sipas paragrafit 2, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 221 të Kodit të Procedurës Penale masën mbrojtëse ndaj dëshmitarit dhe të dëmtuarit mund ta urdhërojë gjyqtari I çështjes, duke u bazuar në kërkesën me shkrim të parqitur nga ana e prokurorit të shtetit, të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit, dëshmitarit apo dëshmitarit bashkëpunues. Mbi kërkesën e tillë prokurori I shtetit duhet të njoftohet menjëherë pas pranimi të saj nga ana e gjyqtarit përkatës. Kërkesa e parashtuar lidhur me mbrojtjen e dëshmitarit apo të dëmtuarit shqyrtohet në seancë dëgjimore të mbyllur. Në seancën e tillë gjyqtari I çështjes mund të urdhërojë masën mbrojtëse për të dëmtuarin apo dëshmitarin, kur konstaton se:

- ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij dhe
- masa mbrojtëse është e domosdoshme për të parandaluar rrezikun serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij.

Kërkesa e tillë duhet të përmbajë deklaratën e pretendimeve fatike, kurse gjyqtari ka për detyrë ta evidencojë kërkesën së bashku me deklaratën në fjalë dhe të njejtat I vendos në një zarf të vulosur me mundësi qasje vetëm për gjyqtarin dhe prokurorin e shtetit (paragrafi 2. Neni 221 KPPK)²²⁹

Pas vlerësimit se janë përmbushur këto dy kushte, paragrafi 1 i nenit 222 I KPPK I ofron mundësi gjyqtarit kompetent që varësisht nga rasti, të jep urdhër për ndërmarrjen e njërës apo të më shumë masave mbrojtëse vijuese:

- lënien bosh ose shlyerjen emrave, adresave, vendit të punës, profesionit apo ndonjë informatë ose të dhëne tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin,
- moszbulimin e ndonjë shkrese që identifikon të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin,
- përpjekjen për të fshehur veçoritë ose përshkrimin fizik të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit që jep dëshminë, duke përfshirë dhënien e dëshmisë prapa një mburoje jo të tejdukshme, përmes paisjeve për ndryshimin e fotografisë ose të zërit, ose marrjen në pyetje të njëkohshme nga një vend tjetër që komunikon me gjykatoren me anën e qarkut të mbyllur televiziv, ose videoregjistrim para seancës së dëgjimit në praninë e mbrojtësit,
- caktimin e pseudonimit,
- seancën e mbyllur për publikun,
- urdhërat ndaj mbrojtësit për të mos zbuluar identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit apo të ndonjë materiali që do të shpie në zbulimin e identitetit të tij,
- largimin e përkohshëm të të pandehurit nga gjykatori nëse dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari, refuzon të dëshmojë në prani të të pandehurit ose nëse rrethanat ia bëjnë të ditur gjykatës se dëshmitari nuk do të flas të vërtetën në prani të të pandehurit,
- cilindo nga kombinimet e masave të përmendura më lart për të parandaluar zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit.²³⁰

Sipas paragrafit 2 të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, për mbrojtjen e kësaj kategorie mund të aplikohen masat mbrojtëse si në vijim:

- mbrojtja fizike,
- zhvendosja e përkohshme,

²²⁹ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

²³⁰ E drejta e Procedurës Penale Azem Hajdari fq 211

- procedurat e veçanta për qasje në të dhëna dhe dokumente nga zyrat e lëshimit të dokumenteve dhe bazës së të dhënave tjera formale,
- ndërrimi I vendbanimit, punës apo shkollimit,
- ndërrimi I identitetit,
- ndryshimi I pamjes fizike, duke përfshirë edhe operacionin plastic,
- mbështetja financiare,
- mbështetja sociale, ligjore dhe çfarëdo mbështetje tjetër e nevojshme,
- regjimi veçantë në institucione korrektuese.²³¹

Urdhëri për masë mbrojtëse jepet me shkrim, por ai nuk duhet të përfshijë informata të cilat mund të qojnë në zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit ose anëtarit të familjes së tij, ose e cila mund të rrezikojë seriozisht sigurinë e veprimeve hetimore dhe fshehtësinë e tyre.

Kur urdhërohet masa mbrojtëse për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin, pala që ka paraqitur kërkesën, mund të kërkojë ndryshimin e masës mbrojtëse. Në këtë rast është gjyqtari kompetent, ai I cili mund të ndryshojë ose anulojë urdhërat ose të autorizojë dhënien e materialit të mbrojtur një gjyqtari tjetër për ta përdorur në procedura të tjera. Nëse në kohën kur bëhet kërkesa për ndryshim apo heqje, gjykata fillestare nuk ka më kompetencë mbi rastin, gjykata kompetente mund të urdhërojë ndryshimin apo heqjen e tillë pasi të ketë njoftuar me shkrim, dhe të ketë dëgjuar qfarëdo argumenti të prokurorit të shtetit (paragrafi 3 dhe 4 i nenit 222 KPPK).

Kur masat mbrojtëse të sipërpërmendura nuk janë të mjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarit, I cili është propozuar nga mbrojtja, zgjidhjet në fuqi ofrojnë mundësi që në rrethana të jashtëzakonshme gjyqtari të mund të urdhërojë anonimitet për publikun, por edhe për të dëmtuarin dhe përfaqësuesin e tij ligjorë ose përfaqësuesit e autorizuar (par.1 neni 223KPPK).²³²

Rrjedhimisht gjyqtari pas mbajtjes se seancës së dëgjimit me dyer të mbyllura, në të cilën merret në pyetje dëshmitari përkatës ose personeli tjetër I nevojshëm siç janë policia dhe personeli tjetër ushtarak që kujdeset për sigurinë, e në të cilën mund të asistojë vetëm prokurori I shtetit, personeli kryesor I gjykatës, iprokurorisë dhe mbrojtësi, merr urdhër për anonimitet kur çmon se:

- ekziston rrezik serioz për dëshmitarin dhe anëtarin e familjes së tij dhe anonimiteti I plotë I dëshmitarit është I nevojshëm për të parandaluar rrezikun e tillë serioz,
- dëshmia e dëshmitarit është e rëndësishme për çështjen sa që e bën të pamundur realizimin e mbrojtjes pa të,
- besueshmëria e dëshmitarit është hetuar dhe zbuluar plotësisht për gjyqtarin në seancë të mbyllur,
- nevoja për anonimitetin e dëshmitarit është më e rëndësishme se sa efekti I interesit të të dëmtuarit për ta ditur identitetin e dëshmitarëve në zbatimin e procedurës (par 2 dhe 3 I neni 223KPPK).²³³

Kur masat mbrojtëse të lartëpërmendura konsiderohen të panjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e të dëmtuarit, dëshmitarit, dëshmitarit bashkëpunues ose të dëshmitarit I cili nuk është propozuar nga mbrojtja, gjyqtari kompetent në rrethana të jashtëzakonshme mund të marrë urdhër për anonimitet me të cilin i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari mbetet anonym edhe për të pandehurin dhe mbrojtësin e tij (par.1 neni224 KPPK).²³⁴

Sipas paragrafit 5 të nenit 224 të Kodit të procedurës penal gjyqtari kompetent mbi bazën e kërkesës së prokurorit të shtetit, merrurrdhër për anonimitet kur pas mbajtjes së seancës së mbyllur në të cilën merret në pyetje I dëmtuari ose dëshmitari në fjalë dhe personeli policer ose ai ushtarak, me çrast të pranishëm mund të jenë prokurori I shtetit, personat tjerë të nevojshëm, siç është personeli I gjykatës dhe ai I prokurorisë që kujdesen për rendin (par.2-4 neni 224 KPPK), çmon se:²³⁵

- ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin apo anëtarin e familjes së tij nëse nuk ruhet anonimiteti I plotë I të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit dhe është e nevojshme të parandalohet rreziku I tillë,

²³¹ Ligji për mbrojtjen e dëshmitarit.

²³² Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

²³³ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

²³⁴ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

²³⁵ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

- dëshmia e dëshmitarit, dëshmitarit bashkëpunues ose e të dëmtuarit është aq e rëndësishme për çështjen sa që e bën të padrejtë realizimin e ndjekjes pa të,
- besueshmëria e dëshmitarit, dëshmitarit bashkëpunues ose e të dëmtuarit është hetuar dhe zbuluar plotësisht për gjyqtarin kompetent në seancë të mbyllur,
- nevoja për anonimitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose e dëshmitarit, në vënien e drejtësisë vlen më shumë se interesi i të pandehurit për të mësuar identitetin e dëshmitarit, dëshmitarit bashkëpunues ose të dëmtuarit gjatë zbatimit të mbrojtjes.

Urdhëri për anonimitet duhet të përpilohet në formë të shkruar dhe ai nuk duhet të përmbajë asnjë informacion që mund të çojë në zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues dhe dëshmitarit apo anëtarit të familjes së tij, ose espozim ndaj ndonjë rreziku serioz për të siguruar zbatimin e hetimeve të fshehta të policisë. Të dhënat nga procesverbali i seancës së mbyllur hiqen nga procesverbali, mbyllen dhe ruhen si fshehtësi zyrtare menjëherë pas identifikimit dhe para marrjes në pyetje të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit. Ndërkaq, të dhënat e kufizuara mund të inspektohen dhe të përdoren nga prokurori i shtetit dhe gjyqtari kompetent vetëm në procedurën e ankimit dhe cila zhvillohet në lidhje me urdhërin e shqiptuar për anonimitet (neni 225 KPPK).²³⁶

Zgjidhjet ligjore e obligojnë gjykatën që të ndalojë bërjen e pyetjeve të atilla, përgjigja e të cilave do të kishte për pasojë zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit të mbrojtur (neni 225 KPPK).²³⁷

PËRFUNDIMI

Procedura e të provuarit është procedura më e rëndësishme dhe vendimtare e procedurës penale ku me një fjalë mund të themi qartë se nga çmuarja e provave të prezentuara në këtë fazë nvaret fajësia apo pafajësia e personit ndaj të cilit zhvillohet procedura. Rol dhe rëndësi padyshim ka edhe dëshmitari si mjeti provues më i shpeshtë në procedurë penale. Roli dhe pozita e tij janë mjaft të rëndësishme për legjislacionin vendor dhe shoqërinë. Dëshmitari në shumë situata është pikë kyçe e një procesi pa të cilin edhe drejtësia nuk do të mund të arrijë qëllimet e saj e që mbi të gjitha është ndarja e drejtësisë. Duhet pasur shumë kujdes gjatë marrjes në pyetje të dëshmitarit në mënyrë që dëshmia e tij si provë të mos I plotësojë kushtet për pavlefshmeri e në raste të cilla do të bëhej provë e papranueshme e cila do ta qonte dëm gjitha përpjekjet për të arritur tek e vërteta sepse në procedurë rëndësi kanë provat e pranueshme sepse vetëm tek ato mund të mbështetet një vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

LITERATURA

- [1] Ejup Sahiti Dëshmia e Dëshmitarit
- [2] Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës
- [3] E drejta e Procedurës Penale Azem Hajdari
- [4] Ligji për mbrojtjen e dëshmitarit.

²³⁶ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës

²³⁷ E drejta e Procedurës Penale Azem Hajdari fq 214

